



USAID
FROM THE AMERICAN PEOPLE

KOSOVO

SNAPSHOT

Shitjet rriten për fermerët, qendrat e grumbullimit dhe tregtarët

Promovimi i USAID-it në komunikim të përmirësuar shton shitjet dhe tregtinë në tregun e perimeve në Kosovë.



Nehat Taç tregon arkat me domate të cilësisë së dorës së parë të cilat i blen qendra e grumbullimit nga fermerët lokal. Ata janë të gatshëm për shpërndarje të shpejtë në qendrën e shpërndarjes ETC.

“Në vend se të marrësh në telefon një furnizues importi, tregu është tani në gjendje për të thirrur qendrën lokale të grumbullimit për sasi të konsiderueshme të perimeve të kultivuara në vend për t'i shpërndarë me shpejtësi.”

~ Mark Wood, drejtor i programit tw USAID nw Kosovo, Zhvillimi Bujqwsor dhe Mundwsitw Rurale (AGRO).



Në Mamushë, dy vajza tregojnë të vjelat e bollshme të kornishonëve gati për t'u transportuar në qendrat e shpërndarjes në mbarë Kosovën

Në kulmin e verës, dhjetëra fermerë nxitojnë të kontaktojnë Nehat Taçin. Kjo është koha më e ngarkuar e vitit për Taçin, pronarin e qendrës grumbulluese Euro Taç në fshatin Mamushë të Kosovës.

Në një mëngjes të kohëve të fundit të korrikut, shumë prej fermerëve të cilët në mënyrë rutinore shesin prodhimet e tyre në linjën e qendrës grumbulluese sjellin arkë pas arke perimet e tyre të sapo vjela. Fermerët janë të lumtur, sepse shitja e çdo gjëje që ata kultivojnë është bërë një punë e lehtë. Më herët, fermerët është dashur vetë të gjejnë tregjet e tyre.

Ndërkohë, dhjetëra kilometra më larg, në fshatin Xërxë, qendra e shpërndarjes e themeluar rishtazi në zinxhirin e supermarketeve të ETC-së, po punon ngushtë me qendrën e grumbullimit. Sa herë që ETC bën porosi për perime të freskëta te Euro Taç, malli i dërgohet të nesërmen në mëngjes. Qendra shpërndarëse e pemëve dhe perimeve e ETC-së rregullisht i furnizon 17 supermarketet në tërë Kosovën me prodhime vendore.

Përveç ETC-së, Euro Taç gjithashtu punon me çdo përpunues, supermarket dhe distributor kryesor tjetër të ushqimit në Kosovë. Këtu përfshihen ABI, Eurofood, Mix Produkt, Koral dhe Ask Foods.

Vetëm për një muaj vjelje të perimeve në 2015, Euro Taç tashmë ka blerë dhe shitur më shumë se 400 ton domate, kornishonë, patate, lakra dhe qepë të prodhuara në nivel lokal. Biznesi është rritur për 30% që nga fillimi i vitit, thotë Taç.

“Euro Taç është bërë furnizues i besueshëm për tregtarët. Ata kanë fituar besim në cilësinë dhe sasinë e produkteve tona. Unë jam i kënaqur nga mënyra se si me sukses ne e kemi filluar sezonin këtë viti,” shpjegon Taç. “USAID-i ka ndihmuar në përmirësimin e marrëdhënieve tona me tregtarët duke lehtësuar takimet tona dhe gjithashtu duke siguruar për ne informacion të vlefshëm për tregun.”

Efikasiteti shtohet përmes sistemit. Kjo vetëm i forcon më tej lidhjet që lidhin fermerët dhe qendrën grumbulluese dhe, nga ana tjetër, qendrën grumbulluese dhe klientët e saj.

Korrik 2015

U.S. Agency for International Development
www.usaid.gov



Me një buzëqeshje, një fermer lokal dorëzon sasinë kornishonëve të sapovjelur në Qendrën e Grumbullimit Euro Taç për një shitje të lehtë.

“Qendra grumbulluese ka arritur një pikë të rëndësishme, ku procesi i tregtimit është bërë shumë më i lehtë dhe më i shpejtë,” thotë Taç.

Mark Wood, drejtor i programit të USAID-it Zhvillimi Bujqësor dhe Mundësitë Rurale (AGRO) sqaron më tej: "Si rezultat i aftësisë së qendrës grumbulluese për të furnizuar sasi të shtuara të prodhimit të njëjtë me cilësi standarde, tregu është bërë më i varur nga qendra e grumbullimit, dhe kështu sasi të e kërkuara janë shtuar në dobi të prodhuesve vendor."

USAID-i përmes projekteve të veta ka promovuar për një kohë të gjatë komunikimin dhe marrëdhëniet e përmirësuara midis kultivuesve, qendrave të grumbullimit dhe tregtarëve. "Kjo jo vetëm që transmeton informacion të rëndësishëm në lidhje me tregun, çmimet dhe kërkesat, por edhe ndërton besimin e krijuar kohëve të fundit në mesin e atyre kultivuesve që bëjnë biznes me qendrat e grumbullimit, dhe atyre qendrave të grumbullimit që me sukses furnizojnë distributorët," tha Wood.